

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN/ Departamenti i përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Behar Ymeri, me sekretaren juridike Fatmire Sermaxhaj, ne çështjen penale ndaj të akuzuarit M.B. nga Gjilani, për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës¹, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.Nr.1201/2018 të datës 10.08.2018, të cilën e përfaqëson prokurori Shefik Memeti pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar më datë 27.11.2018, mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri M.B. i lindur më ..., me numër personal të Austrisë ..., i biri i F.B. dhe nënës H., e gjinisë R., me vendbanim në Gjilan “ ... ” Kati i parë nr. 3 banesa te “ ... ” rruga e ..., ka të kryer shkollën fillore, i martuar- baba i 3 fëmijëve, pensionist, i gjendjes së mesme, shqiptar shtetas i Austrisë, i pa dënuar më parë dhe nuk udhëhiqet procedurë tjetër penale.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datën 07.08.2018, rreth orës 11:00 minuta në Gjilan, në rrugën “Qarkore”, i pandehuri, nga pakujdesia, ka rrezikuar trafikun publik duke vënë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre, ashtu që duke drejtuar automjetin e markës “VW Golf” me tabela ..., ka vepruar në kundërshtim të dispozitës ligjore të nenit 41.1 të Ligjit për Rregullimin e Trafikut Rrugor, duke lëvizur në rrugën “Qarkore”, nga rruga e “Prishtinës” në drejtim të rrugës së “Kamenicës”, me të arritur përballë “NTP Lumi Sport”, i pandehuri fillon një kthim të pa sigurt majtas për në parkingun e autolarjes dhe pasi kalon shiritin e kundërt të lëvizjes, me anësoren, mbrojtësin e përparmë të anës së djathtë, ndeshet me pjesën e përparme të motoçikletës, të markës “Yamaha YP” 125, të cilën e drejtonte i dëmtuari, Xh.M. i cili ishte duke lëvizur në rrugën “Qarkore”, nga rruga e “Kamenicës”, në drejtim të rrugës së “Prishtinës” që ishte në shiritin e vet të lëvizjes, me përparësi kalimi, në raport me automjetin, me ç ‘rast shkaktohet aksident trafiku me dëme materiale dhe lëndime trupore, ku lëndime të lehta trupore pëson i dëmtuari: Xh.M., i cili kërkon ndihmë mjekësore në Spitalin e Përgjithshëm në Gjilan Emergjencë dhe pas trajtimit mjekësor të njëjtën ditë lirohet në shtëpi.

-me çka ka kryer veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 41, 46, 73 dhe 75 të KPRK, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të akuzuarin,

D E N I M M E G J O B Ë

Të pandehurit M.B., i shqiptohet dënim me gjobë në shumë prej 300 € (treqindë) euro, të cilin dënim do ta paguaj në afat prej 15 ditë, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri refuzon të paguajë dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje ta paguaj atë, atëherë dënimi me gjobë me pajtim me të pandehurin zëvendësohet me punë në dobi të

¹ *Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejshëm KPRK), nr.04/L-082, i datës 20.04.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.*

përgjithshme ashtu që 8 (tetë) orë të punës do të barazohen me 20.00 € (njëzet euro), ndërsa nëse i pandehuri nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë në punë në dobi të përgjithshme, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20.00 € (njëzet euro) do ti caktohet një ditë burgim.

Pala e dëmtuar, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest juridiko civil. I pandehuri obligohet të paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumën prej 20.00 € (njëzet euro), në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Të akuzuarit i shqiptohet taksa për kompensimin e viktimave të krimit, në shumën prej 30.00 € (tridhjetë euro), në bazë të nenit 39 paragrafi 3, nën paragrafi 1.3 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

ARSYETIM

1. Rrjedha e çështjes dhe fjala përfundimtare e palëve

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 10.08.2018, ka ngritur aktakuzën PP.II.Nr.1201/2018, kundër të akuzuarit M.B., me vendbanim Gjilan, për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Në shqyrtimin fillestar dhe publik të datës 27.11.2018 ku ishin prezent prokurori i shtetit Shefik Memeti, i pandehuri M.B., në të cilën seancë i pandehuri pas leximit të aktakuzë deklaroi se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale

2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të prokurorit të shtetit, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit M.B., me vendbanim në Gjilan, për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar as i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike, duke u bazuar në format e kualifikuara të kësaj vepre penale, ekziston fakti se i pandehuri M.B. ka kryer veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe nenin 41.1 paragrafi 1 të ligjit për Rregullat trafikun rrugor të Kosovës në kohën, vendin, dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Gjykata, pas dëgjimit të deklaratave të palëve lidhur me dënimin, e ka shpallur fajtor të akuzuarin duke u bazuar në format e kualifikuara të kësaj vepre, ekziston fakti se i pandehuri M.B., për shkak të veprës penale, Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s dhe nenin 41.1 paragrafi 1 të ligjit për Rregullat trafikun rrugor të Kosovës. Ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e veprës penale dhe se për të njëjtën është dhe penalisht përgjegjës.

Në bazë të nenit 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së Rrezikim i trafikut publik konsiderohet;

1. Kushdo që shkel ligjin mbi trafikun publik apo transportin rrugor dhe rrezikon jetën e njerëzve apo pasurinë dhe me këtë i shkakton dikujt lëndim të lehtë trupor ose dëm pasuror, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

6. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2 i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit

5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenit 73, 74, 75 dhe 76 të KPRK-s, ka vlerësuar se duhet të pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe të njëjtit të i caktohet dënimi me gjobë në shumë prej 300 (terqindë) euro, të cilin denim do ta paguaj në afat prej 15 ditë pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë.

Duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat ky dënim do të jetë dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale, ashtu që për të akuzuarin M.B. si rrethanë posaçërisht lehtësuese ka marrë faktin se i akuzuari ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, dhe se i njëjti është penduar, i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen do te ketë me tepër kujdes gjate drejtimit te automjeteve dhe nuk do të kryej vepra tjera penale, ndërsa si rrethana rënduese gjykata gjeti dëmin e shkaktuar në automjete dhe lëndimet trupore të dëmtuarit.

6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së gjyqtarit të vetëm gjykues dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit M.B., duke marr parasysh rrethanat e përmendura më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit.

Gjyqtari po ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-s, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Pala e dëmtuar, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest juridiko civil.

8. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare e të pandehurit, gjykata, duke u bazuar nënen 453 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë për ta paguar shpenzimet e procedurës penale, dhe paushallin gjyqësor, si dhe taksa për Kompensimin e Viktimave në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr. 673/2018, Me datë 27.11.2018

Sekretarja Juridike

Fatmire Sermaxhaj d.v

Gjyqtari

Behar Ymeri d.v

KËSHILLA JURIDIKE;Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë / Departamentit të përgjithshëm në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit e të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate